



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2020
Nr. Dok. 202002780/2

Lënda: *Rekomandime mbi inspektimin e kryer në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë (DVPT) dhe komisariatet e policisë nr.1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, lidhur me masat e marra për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.*

Drejtuar: DREJTORISË VENDORE TË POLICISË TIRANË

TIRANË

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar,¹ pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, kreu një inspektim në datat 18 dhe 19 Qershor 2020 në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe komisariatet e policisë nr.1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, në varësi të saj.

Inspektimi kishte për qëllim, verifikimin e masave të marra në zbatim të Aktit Normativ Nr.3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", i ndryshuar, Urdhrit Nr.156, datë 10.3.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", i ndryshuar, Urdhrit Nr.3614/1 datë 26.05.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme për hartimin e planit të masave mbrojtëse ndaj COVID-19 sipas kërkesave të parashikuara në Rregulloren e Departamentit të Administratës Publike "Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", si dhe një seri urdhrash e porosish të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për këtë qëllim.

¹Neni 81 i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar, si dhe znj.Fjona Zaçaj me detyrë nd/komisionere pranë Seksionit të Veçantë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Për periudhën e pandemisë, Mekanizmi Kombëtar (MKPT) për shkak të orareve të kufizuara të lëvizjeve, respektimit të protokollit për distancimin fizik e social, të përcaktuara në aktin normativ të miratuar nga Qeveria Shqiptare, ka ushtruar funksionet e tij, nëpërmjet kontaktit me email me drejtuesit e institucioneve ku mbahen dhe trajtohen personat e privuar nga liria, për dërgimin e informacioneve në lidhje me respektimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve në mjediset e policisë, masat e marra në mbrojtje të shëndetit të punonjësve të policisë, ofrimin e shërbimeve të qytetarëve, si dhe respektimin e protokollit nga drejtuesit dhe punonjësit e policisë për parandalimin e infeksionit COVID-19, në ambientet e punës gjatë dhe pas lirimit të masave shtrënguese të kushtëzuara nga gjendja e jashtëzakonshme.

Institucioni i Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se pandemia e Coronavirus (COVID-19) ka krijuar sfida të jashtëzakonshme për të gjithë autoritetet dhe institucionet shtetërore. Ndërkohë, stafet që punojnë në vende të ndryshme të privimit të lirisë, ku përfshihen institucionet policore, institucionet e vuajtjes së dënimit, qendrat e paraburgimit të imigracionit, spitalet psikiatrike dhe shtëpitë e kujdesit shoqëror etj., janë gjendur përballë sfidash specifike edhe më të vështira.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksojmë gjithashtu se, marrja e masave mbrojtëse në kuadër të gjendjes së jashtëzakonshme, nuk duhet të konsistojnë në trajtim çnjerëzor ose degradues të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë.

Në ushtrimin e detyrës, Mekanizmi Kombëtar dhe përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit, janë mbështetur në parimet e CPT-së të deklaruara në datë 20 mars 2020², referuar trajtimit të personave të privuar nga liria në kontekst të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, të cilat po i referojmë si më poshtë vijon:

1. Parimi themelor ka të bëjë me ndërmarrja e të gjitha veprimeve të mundshme për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e të gjithë personave të privuar nga liria e tyre. Kjo, pasi ndërmarrja e këtyre veprimeve kontribuon edhe në ruajtjen e shëndetit dhe të sigurisë të stafit të punonjësve të policisë.
2. Udhëzimet e OBSH-së për luftimin e pandemisë dhe ruajtjen e shëndetit kombëtar, si dhe udhëzimet klinike në përputhje me standardet ndërkombëtare, duhet të respektohen dhe zbatohen me rigorozitet për të gjitha vendet e privimit të lirisë.
3. Disponueshmëria e stafit duhet të përforcohet dhe personeli duhet të marrë të gjithë mbështetjen profesionale, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë, si dhe trajnimin e nevojshëm, për të qenë në gjendje të vazhdojnë përmbushjen e detyrave të tyre në vendet e privimit të lirisë.
4. Çdo masë kufizuese e marrë ndaj personave të privuar nga liria e tyre për të parandaluar përhapjen e COVID-19, duhet të ketë një bazë ligjore dhe të jetë e nevojshme, proporcionale, respektuese e dinjitetit njerëzor dhe e kufizuar në kohë. Personat e privuar

² <https://rm.coe.int/16809cfa4b>

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/covid-19-council-of-europe-anti-torture-committee-issues-statement-of-principles-relating-to-the-treatment-of-persons-deprived-of-their-liberty->

nga liria e tyre duhet të marrin informacion të plotë, në një gjuhë që ata kuptojnë, për një masë të tillë.

5. Kontakti i ngushtë personal (mosrespektimi i distancave) shkakton përhapjen e virusit, ndaj duhet të bëhen përpjekje të përbashkëta nga të gjitha autoritetet për të përdorur masa alternative të privimit të lirisë. Një qasje e tillë është e domosdoshme, në veçanti, në situatat e mbipopullimit. Autoritetet ligjzbatuese duhet të përdorin më shumë alternativa të paraburgimit, zbutjen e dënimeve, lirimimin e hershëm dhe shërbimin e provës, rivlerësimin e nevojës për të vazhduar me vendosjen e pavullnetshme të pacientëve psikiatrikë, rehabilitimin ose lënien në kujdesin e komunitetit, kudo që është e përshtatshme, banorë të shtëpive të kujdesit shoqëror, si dhe të përmbahen në masën maksimale të mundur nga ndalimi i migrantëve.

6. Sa i përket ofrimit të kujdesit shëndetësor, vëmendje e veçantë kërkohet t'i kushtohet nevojave specifike të personave të ndaluar, në veçanti grupeve vulnerabël dhe / ose grupeve të rrezikuara, siç janë personat e moshuar dhe personat me sëmundje shoqëruese. Kjo përfshin, ndër të tjera, ekzaminimin për COVID-19 dhe rrugët për në kujdesin intensiv siç kërkohet. Më tej, personat e ndaluar duhet të marrin mbështetje shpesh psikologjike nga stafi në këtë kohë.

7. Ndërsa është e ligjshme dhe e arsyeshme të pezullohen aktivitetet jo-thelbësore, të drejtat themelore të personave të ndaluar gjatë pandemisë duhet të respektohen plotësisht. Kjo përfshin veçanërisht të drejtën për të mbajtur higjienën adekuate personale (përfshirë aksesin në ujë të nxehtë dhe sapun) dhe të drejtën e përditshme për të dalë në ajrim (së paku një orë). Më tej, çdo kufizim për kontaktin me botën e jashtme, përfshirë vizitat, duhet të kompensohen nga rritja e qasjes me mjetet alternative të komunikimit (të tilla si komunikimi telefonik ose me internet).

8. Në rastet e izolimit ose vendosjes në karantinë të një të personi të ndaluar i cili është i infektuar ose dyshohet të jetë infektuar nga SARS-CoV-2 virusi, këtij personi duhet t'i sigurohet kontakt njerëzor domethënës çdo ditë.

9. Masat mbrojtëse themelore, kundër keqtrajtimit të personave nën kujdestarinë e zyrtarëve të zbatimit të ligjit (qasja te një avokat, qasja te mjeku, njoftimi i kujdestarit) duhet të respektohen plotësisht në të gjitha rrethanat dhe në çdo kohë. Masat paraprake (të tilla si të kërkosh që personat me simptoma të veshin maska mbrojtëse) mund të jenë të përshtatshme në disa rrethana.

10. Monitorimi nga organizmat e pavarura, përfshirë Mekanizmat Kombëtare parandaluese (MKPT) dhe CPT, mbetet një mbrojtje thelbësore kundër keqtrajtimit. Shtetet duhet të vazhdojnë të garantojnë aksesin e organeve të monitorimit në të gjitha vendet e ndalimit, përfshirë vendet ku mbahen personat në karantinë. Të gjithë organet e monitorimit duhet të marrin gjithsesi çdo masë paraprake për të vëzhguar parimin "mos bëj dëm", në veçanti kur kemi të bëjmë me persona të moshuar dhe persona me sëmundje shoqëruese.

Në kuadër të zbatimit të udhëzimeve të CPT-së dhe nga monitorimi në tërësi i situatës në drejtorinë dhe komisaritet e policisë në Tiranë, rezultoi se:

- Në Drejtorinë Vendore të Policisë dhe komisaritet e policisë, Tiranë, kishte rregullore të miratuar për zbatimin e masave për parandalimin e pandemisë COVID-19 në mjediset e policisë, vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme. Drejtuesit e drejtorisë dhe komisariateve të policisë, duhet të kishin parashikuar në këtë rregullore

masa edhe për periudhën post-gjendjes së jashtëzakonshme, në mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë, por dhe të stafit të punonjësve të policisë.

- Në takimin me drejtues të policisë në Tiranë, grupi i inspektimit konstatoi se, masat mbrojtëse të ndërmarra për pajisjen e stafit me maska, dizifektantë dhe doreza, ishin përballuar me fonde buxhetore të tyre apo me donacione nga subjekte private dhe nuk ishin rialokuar buxhet shtesë për këtë qëllim nga qeveria shqiptare. Për shkak të situatës së krijuar, si pasojë e përhapjes së COVID-19, është bërë i mundur me vështirësi furnizimi me maska, doreza e dezinfektues, pasi ato nuk kanë qenë të parashikuara në buxhetin përkatës të Drejtorisë të policisë.
- Struktura përgjegjëse në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe komisariatet e policisë gjatë periudhës mars-qershor 2020, kishte kryer dezinfektimin e të gjitha ambienteve të punës, si dhe ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në drejtori dhe komisariatet e varësisë, sipas një grafiku në 5 faza, për periudhën Mars-Qershor, të cilat ishin shtuar gjatë muajit të fundit, duke përkuar në intervalin një herë në javë. Dezinfektime shtesë në disa komisariate ishin kryer me iniciativë nga strukturat e pushtetit vendor të Bashkisë Tiranë dhe subjekte private. Nuk ishte përcaktuar në asnjë akt, qoftë urdhër apo rregullore, ku të parashikohej shprehimisht kryerja e dezinfektimeve të ambienteve.
- Në kuadër të këtyre masave dhe në zbatim të urdhrave dhe porosive të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, rezultonte se ishin shoqëruar një numër i vogël i shtetasve në mjediset e policisë, duke marrë masa për parandalimin e ngjarjeve dhe duke qenë më shumë prezent në terren për kryerjen e verifikimeve të nevojshme.
- Emrat e personave të identifikuar nga strukturat e Institutit të Shëndetit Publik Tiranë, të infektuar nga ky virus ishin shpërndarë sipas vendbanimeve në komisariatet respektive dhe monitoroheshin nga inspektorët e zonave, kryesisht përmes telefonatave, duke ju rikujtuar respektimin e rregullave të karantinimit. Lidhur me rezultatet e verifikimit, çdo ditë raportohej për këtë problematikë në DVP Tiranë.
- Kishte pasur raste të kryerjes së disa testime me tamponë për punonjësit e policisë të komisariateve që kishin shfaqur shenja të sëmundjes, por në përfundim kishin rezultuar negativë. P.sh në komisariat nr.1 ishin kryer 8 testime, në komisariat nr.5 ishin kryer 4-5 testime.
- Mbledhjet me stafet përkatëse zhvilloheshin online, ose në salla të mëdha dhe të ajrosura, duke ruajtur distancën fizike mes tyre dhe zbatimin e rregullores.
- Nga komunikimi me drejtuesit dhe stafin e policisë, na u referua se furnizimi me ujë dhe energji elektrike, ka qenë pa ndërprerje gjatë 24 orëve. Nga inspektimi i ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë, u konstatua se kishte ujë dhe energji elektrike pa ndërprerje.
- Problem shqetësues vijnë të mbeten kushtet e papërshtatshme të ambienteve të sigurisë në komisariatet e policisë nr.1, 2 dhe 3, të cilat nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim. Ndonëse këto problematika, janë adresuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar

në raportet me rekomandimet përkatëse gjatë inspektimeve periodike të kryera nga Mekanizmi Kombëtar pranë Avokatit të Popullit, situata ende vazhdon të jetë e njëjtë.

- Po ashtu, gjatë inspektimit u konstatua mbipopullim në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe në komisariatit nr.3. Kjo problematikë, përveç se është në kundërshtim me standardet e përcaktuara, në kohë pandemie mund të paraqesë rrezikshmëri si për personat që futen në këto ambiente, ashtu edhe për personelin policor që kryejnë shërbim në këtë ambient. Avokati i Popullit ka konstatuar mbipopullim të ambienteve të shoqërimit dhe atyre të sigurisë edhe në periudha të tjera të kaluara, në veçanti gjatë protestave të zhvilluara gjatë vitit 2019 dhe 2020.

Krahas masave të marra nga strukturat përgjegjëse në DVP Tiranë dhe drejtuesit e komisariateve, nga inspektimi u konstatuan edhe disa problematika, duke iu referuar në veçanti si më poshtë vijon:

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Nga inspektimi i ushtruar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, (DVPT) grupi i punës fillimisht kontaktoi me zv/drejtorin e kësaj drejtorie z.Dhimitraq Ziu dhe më tej vijoi inspektimin i shoqëruar nga shefi i rendit dhe përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Grupi i inspektimit u njoh nga shefi i rendit me dosjen e dokumentacionit të krijuar për këtë qëllim, përmbajtjen e Urdhrit nr.3614/1 datë 26.05.2020 të Drejtorit të DVP Tiranë “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, si dhe rregulloren e brendshme të miratuar mbi bazën e rregullores të Departamentit të Administratës Publike. Ky urdhër dhe rregullorja e brendshme, ju ishin dërguar për zbatim të gjithë komisariateve të policisë në varësi të kësaj drejtorie.

Në vijim të marrjes së informacionit, grupi i inspektimit u takua edhe me drejtorin ekonomik të kësaj drejtorie, i cili vuri në dispozicion dokumentacionin për dezinfektimin e ambienteve të drejtorisë dhe të komisariateve në varësi të saj, të kryer në 5 faza brenda afatit 1 muaj, si dhe planin e shpërndarjes të furnizimit me maska mbrojtëse, doreza dhe dezinfektues për stafet e drejtorisë dhe të komisariateve të policisë, Tiranë.

Gjatë inspektimit të ambienteve të punës, ambientit të shoqërimit dhe të sigurisë të kësaj drejtorie, u konstatua se në hyrje të saj ishte vendosur “ura dezinfektuese”. Zyra e informacionit dhe ajo e shërbimeve ndaj qytetarëve ishte e pajisur me dezinfektues dhe punonjësit e policisë në momentin e inspektimit mbanin maska mbrojtëse. Në ambientet e brendshme dhe jashtë saj, ishin afishuar postera informues ku tregohej respektimi i protokollit dhe shenja dalluese për ruajtjen e distancës të shtetasve nga njëri-tjetri.

Megjithatë, gjatë vizitës inspektuese të ushtruar në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë u konstatuan dhe disa punonjës policie pa maska mbrojtëse, pa doreza dhe mungesë të dezinfektantëve për pastrimin e duarve.

Gjithashtu, në ditën e inspektimit në dhomat e sigurisë të DVP Tiranë, ndodheshin të akomoduar 19 persona të arrestuar/ndaluar, nga 10 persona që është kapaciteti fizik i këtyre dhomave. **Mbipopullimi në dhomat e sigurisë ka qenë dhe mbetet një problem i konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme në DVP Tiranë, pasi përbën trajtim jodinjitoz të shtetasve në dhomat e sigurisë, por gjatë periudhës së pandemisë ku**

kërkohet të zbatohen masa strikte lidhur me higjienën personale dhe distancimin fizik të këtyre personave, situata bëhet edhe më shqetësuese.

Sipas komunikimit, furnizimi me ujë dhe energji elektrike në ambientet e drejtorisë së policisë, nuk ishte ndërprerë gjatë gjithë periudhës të pandemisë.

Personat e ndaluar/arrestuar ishin të furnizuar me detergjentë dhe sapunë sipas normativave mujore.

Në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë ishte në dispozicion një termometër dixhital për matjen e temperaturës të personave që qëndrojnë në këto ambiente.

Kushtet higjieno-sanitare në dhomat e sigurisë nuk ishin të mira, për shkak dhe të mbipopullimit dhe akomodimit të dy dhe tre personave në një dhomë.

Komisariati Policisë nr.1

Grupi i punës u paraqit në Komisaratin e Policisë nr.1, ku kontaktoi me shefin e këtij komisarati të caktuar në detyrë, z. Oligert Torba.

Z. Torba informoi se, është nxjerrë një urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe njëkohësisht është shpërndarë nëpër komisarate një letër porosi, me qëllim marrjen e masave dhe në kuadër të situatës së emergjencës shëndetësore dhe për parandalimin e sëmundjes së COVID-19.

Nga inspektimi rezultoi se, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ishte bërë furnizimi me maska mbrojtëse, dezinfektues dhe detergjentë, mbi bazën e një plani shpërndarje të miratuar nga sektori ekonomik. Ndërkohë, sipas planifikimit vjetor, ishte bërë gjithashtu edhe furnizimi me detergjentë për mbajtjen e higjienës personale dhe të ambienteve të brendshme të drejtorisë.

Sipas informacionit, Komisarati nr.1 Tiranë ka një numër shumë të lartë punonjësish policie, në total rreth 428 persona, duke qenë njëkohësisht edhe komisarati më i madh në Shqipëri. Furnizimi me maska nga drejtoria ishte bërë 2 herë gjatë periudhës së pandemisë për muajt mars-qershor 2020, me maska të tipit një ose disa përdorime. Furnizimi i fundit ishte bërë më datë 30.04.2020 me 370 maska mbrojtëse, 740 doreza, 370 xhel dezinfektues 80 ml, 5 copë 500 ml. Së fundmi, ishin pajisur edhe me 200 maska të tjera me disa përdorime.

Me këto materiale, ishin pajisur gjithashtu edhe zyrat e punës dhe personeli administrativ. Maskat duke qenë në numër të vogël në raport me numrin e lartë të punonjësve të këtij komisarati, ishin shpërndarë kryesisht te punonjësit e patrullave që përballen me qytetarët më shumë dhe gjenden në terren. Furnizimi me sapunë dhe detergjentë ishte bërë sipas planifikimit vjetor të drejtorisë. Ky komisarati ishte pajisur me maska mbrojtëse dhe dezinfektantë shtesë, nga donacionet e sjella nga komunitetet fetare që ndodhen në territorin e këtij komisarati policie.

Gjithashtu, grupi i inspektimit u informua se, ishin kryer 5 dezinfektime nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në të gjithë ambientet e komisarimit gjatë periudhës mars-qershor 2020. Në hyrje dhe në disa ambiente të brendshme të komisarimit, ishin afishuar disa postera ku kërkohet respektimi i protokollit shëndetësor dhe distancës nga njëri-tjetri të shtetasve.

Në kuadër të këtyre masave, ishte vendosur edhe rregulli për të shmangur sa më shumë shoqërimet e shtetasve në komisariate, duke kryer verifikime në terren nga specialistët dhe patrullat e policisë të ndarë sipas zonave.

Dhomat e sigurisë,që duhet të mbylleshin për shkak të mungesës të kushteve teknike e materiale, sipas rekomandimit të CPT-së gjatë vizitës inspektuese të zhvilluar në vitin 2018 në Shqipëri, të konstatuara edhe nga Mekanizmi Kombëtar në inspektimet periodike, vijonin të ishin të hapura.

Furnizimi me ujë dhe energji elektrike kishte qenë i pandërprerë gjatë periudhës së emergjencës shëndetësore, por kushtet higjieno-sanitare në dhomën e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë kishin nevojë për përmirësim. Furnizimi me ujë kryhej nga Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve Tiranë.

Në momentin e inspektimit në komisarifat nuk kishte persona të shoqëruar, të ndaluar apo arrestuar. Rreth 8 testimet të kryera te punonjësit e policisë të këtij komisarifat, kishin rezultuar negativë. Ndërsa, mbledhjet me stafin bëheshin online, ose në salla të mëdha e të ajrosura, duke ruajtur distancën.

Komisariati i Policisë nr. 2

Grupi i punës u takua me shefin e komisarifatit nr.2, z.Olti Bistri dhe shefin e rendit, z.Munir Muça.

Nga informacioni, rezultoi se, si në Komisarifat e policisë nr.2 për periudhën mars-qershor 2020 ishte bërë dezinfektimi në mënyrë periodike i të gjithë ambienteve të tij në 5 faza, nga struktura përgjegjëse në DVP Tiranë. Dezinfektimet shtesë ishin kryer edhe nga Bashkia Tiranë dhe subjekte private të siguruar nga drejtuesi i komisarifatit.

Gjatë periudhës së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, ky komisarifat është furnizuar me maska dhe dezinfektantë për periudhën prill-maj dhe së fundmi më 14.06.2020, ishte pajisur me 100 copë maska dhe dezinfektantë. Ndërkohë, drejtuesi i komisarifatit kishte siguruar masa mbrojtëse shtesë, duke bashkëpunuar edhe me bizneset në këtë zonë.

Furnizimi me detergjentë dhe sapunë është bërë rregullisht dhe nuk kishin mungesa.

Gjithashtu edhe furnizimi me ujë dhe energji elektrike nuk ishte ndërprerë gjatë gjithë kësaj periudhe. Furnizimi me ujë kryhej nga Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve Tiranë. Komisarifat i policisë nuk kishte termometër dixhital për matjen e temperaturës për punonjësit e policisë por dhe qytetarëve që kryenin shërbime në mjediset e tij.

Në dhomat e shoqërimit dhe sigurisë, si dhe korridoret e godinës, ishin vendosur mjete dezinfektimi dhe mbrojtjeje (dezinfektues, maska, doreza) për punonjësit e policisë.

Në ambientet e zyrës të shërbimit të qytetarëve ishin afishuar fletët që rikujtonin masat mbrojtëse ndaj COVID-19, por nuk kishte shenja orientuese që vendosen në tokë për ruajtjen e distancës së rekomanduar prej rreth 1.5 metra. Në ambientet e zyrës së shërbimeve ndaj qytetarëve, u konstatuan punonjës të policisë që ushtronin detyrën pa maska mbrojtëse.

Ndërkohë mbeten ende problem i pazgjidhur dhomat e sigurisë për të arrestuarit në komisariat nr.2, për vetë kushtet e papërshtatshme dhe ato higjieno-sanitare, që paraqesin këto ambiente.

Grupi i punës, në momentin e inspektimit gjeti vetëm një person të shoqëruar në dhomat e shoqërimit, ndërsa në dhomat e sigurisë ndodheshin 2 persona në pritje të vleftësimit të masës së sigurisë nga gjykata.

Komisariati Policisë nr.3

Në komisariat nr.3 grupi i inspektimit u takua me shefin e sektorit të shërbimeve mbështetëse, pasi shefi i komisariatit Kryekomisar Edmond Mersini nuk gjendej në ambientet e komisariatit për arsye pune.

Në këtë komisariat, në hyrje ishte një punonjëse e policisë e cila ishte e pajisur me një termometër dixhital, e cila maste temperaturën e çdo shtetasi që hynte brenda ambienteve. Punonjësit ishin të pajisur me maska gjatë kryerjes së detyrës së tyre. Ambientet e punës, si dhe ato të shoqërimit dhe të sigurisë, ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Në ambientet e komisariatit mungonin afishimet dhe posterat për njoftimin e ruajtjes së distancës, edhe pse punonjësit e policisë ishin të organizuar për shmangien dhe grumbullimin e njerëzve.

Komisariati i policisë nr.3, kishte në organikë rreth 272 punonjës policie në varësi të tij dhe në shërbim të komunitetit. Furnizimet me maska mbrojtëse dhe doreza ishin siguruar si nga drejtoria e policisë, por edhe nga donacione të ndryshme. Për shkak të numrit të kufizuar, me maska ishin furnizuar me prioritet më së shumti punonjësit e patrullave të policisë që ushtronin detyrën e tyre në terren.

Dezinfektuesit për pastrimin e duarve, ishin 80 ml dhe 500 ml. Furnizimi i fundit nga sektori ekonomik në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë ishte kryer në datë 31 maj, me 200 maska mbrojtëse, 200 doreza dhe 100 dezinfektues.

Furnizimi me detergjentë dhe sapunë ishte bërë rregullisht dhe nuk kishte mungesa.

Dezinfektimi i ambienteve të komisariatit ishte kryer sipas grafikut 5 herë gjatë periudhës mars-qershor, nga subjekti privat i kontraktuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

Sipas komunikimit, furnizimi me ujë dhe energji elektrike ka qenë i pandërprerë përgjatë 24 orëve. Furnizimi me ujë bëhej nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë.

Në ambientet e shoqërimit nuk kishte persona të shoqëruar, ndërsa në ambientet e sigurisë gjendeshin 4 persona, 3 në një dhomë dhe 1 në dhomën tjetër. Dhomat e sigurisë në këtë komisariat, janë me përmasa të vogla 2x2m dhe tjetra 3x2m. Dhomat nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 m², dhe nuk ishin të ndara në ambient qëndrimi në dhomë 6 m² dhe dhe paradhomë 4m², sikurse përcaktohet në kriteret e miratuara në procedurat standarde.³ Qëndrimi në këto kushte i personave të shoqëruar apo ndaluar, paraqet rrezikshmëri të lartë infektimi të shtetasve të privuar nga liria, por edhe për stafin e policisë që kryejnë shërbimin në këto

³ *Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".*

ambiente. Gjithashtu, dhomat ishin pa krevatë, të pajisura vetëm me dyshekë sfungjeri të shtrirë në tokë, pa lavaman për larjen e duarve, si dhe me dritare të vogla që nuk lejonin hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale.

Për të shoqëruarit na u referua se procedurat e verifikimit realizoheshin në terren dhe nuk mbaheshin nëpër dhoma për shkak të situatës së COVID-19.

Komisariati i Policisë nr. 4

Në Komisarlatin nr. 4 Tiranë, grupi i punës u takua me shefin e rendit z.Roven Zeka, i cili vuri në dispozicion gjithë dokumentacionin me urdhra dhe udhëzime të DVP Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për marrjen e masave anti COVID – 19.

Nga inspektimi u vu re se që në hyrje të komisarlatit, si edhe në ambientet e brendshme të tij, ishin marrë masa dukshëm shumë më të mira në krahasim me komisarlatet e tjera.

Në zyrën e shërbimit të qytetarëve dhe korridoret e godinës ishin afishuar postera informues që rikujtonin marrjen e masave anti COVID-19, në dysheme ishin ngjitur shenja dalluese për ruajtjen e distancave, si dhe punonjësit e policisë ishin të gjithë të pajisur me maska mbrojtëse e doreza.

Ashtu si në komisarlatet e tjera dhe në këtë komisarlat, ishte kryer dezinfektimi nga DVP Tiranë në mënyrë periodike. Më datë 28.05.2020 ky komisarlat ishte pajisur me 672 maska, doreza dhe dezinfektantë nga sektori ekonomik i DVP Tiranë.

Furnizimi me detergjentë dhe sapunë ishte bërë sipas planit vjetor të DVP Tiranë dhe nuk kishte mungesa.

Në ambientin e zyrës të shërbimeve ndaj qytetarëve, nuk kishte termometër dixhital për matjen e temperaturës.

Gjatë kësaj periudhe, furnizimi me ujë dhe energji elektrike kishte qenë i pandërprerë përgjatë 24 orëve.

Dhomat e shoqërimit të komisarlatit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare dhe gjatë inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Komisariati i Policisë nr.5

Grupi i inspektimit në këtë institucion kontaktoi me shefin e këtij komisarlati Kryekomisar Altin Lila. Numri i punonjësve të këtij komisarlati sipas organikës ishte rreth 144 persona.

Furnizimi me maska dhe doreza ishte bërë nga drejtorja sipas një plani të miratuar nga DVP Tiranë. Por, nuk kishte munguar furnizimi me mjete mbrojtëse për punonjësit e policisë edhe nga fasoneritë të cilat gjenden në territorin e këtij komisarlati, duke u ardhur në ndihmë gjatë periudhës së emergjencës shëndetësore, por edhe gjatë muajve maj dhe qershor. Furnizimi i fundit me 200 copë maska mbrojtëse ishte bërë në muajin maj 2020 nga Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë. Nisur nga fakti se ky komisarlat krahasuar me të tjerët ka një numër më të vogël punonjësish, edhe furnizimi ishte i mjaftueshëm.

Grupi i inspektimit, u informua se ishte bërë dezinfektimi i ambienteve të komisarlatit nga firma e kontraktuar nga Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë 5 herë sipas grafikut për

periudhën mars-qershor 2020. Gjithashtu, në këtë komisariat ishin bërë dezinfektime edhe nga Bashkia Kamëz. Dezinfektuesit ishin 80 ml dhe 500 ml të cilët ishin vendosur në të gjitha ambientet e dukshme të tij.

Ky komisariat kishte në mbikëqyrje rreth 27 persona të infektuar që i përkisnin zonës që mbulon komisariati, të cilët kontaktoheshin çdo ditë nga inspektorët e policisë përmes numrave të telefonit dhe adresave të banimit, duke ju rikujtuar detyrimin për të qëndruar të izoluar në banesat e tyre.

Në komisariat furnizimi me ujë dhe energji elektrike ishte i pandërprerë përgjatë 24 orëve. Furnizimi me ujë kryhej nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Kamëz.

Në momentin e inspektimit ishte prezent vetëm një person i arrestuar. Në ambientin e sigurisë kishte dezinfektues dhe personi ishte i informuar për rregullat që duhet të respektonte.

Ambienti i pritjes së qytetarëve ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare, nuk kishte njerëz në momentin e inspektimit dhe dy punonjëset e policisë që kryenin shërbim në këtë ambient, ishin të pajisura me maska dhe dezinfektues. Në ambientet e komisariatit ishin afishuar disa postera në mur dhe shenja dalluese në tokë, ku kërkohej respektimi i protokollit dhe distancës nga njëri-tjetri të paktën 1,5 m.

Në këtë komisariat, nuk kishin termometër për matjen e temperaturës së shtetasve që vinin aty për marrjen e shërbimit, por dhe të stafit të këtij komisariati.

Komisariati i Policisë nr.6

Në vizitën inspektuese në komisariatin e policisë nr.6, grupi i inspektimit u takua me shefin e seksionit të patrullës së përgjithshme z.Vendim Ymeraj, në mungesë të shefit të komisariatit, i cili informoi për masat e marra nga drejtuesit e komisariatit për zbatimin e masave të përcaktuara në rregulloren, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dërguara nga organet eprore në DVP Tiranë dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit, për periudhën e emergjencës shëndetësore në parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19 dhe protokollin shëndetësor për periudhën në vijim të kalimit në normalitet.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në kuadër të masave anti-COVID-19, strukturat përgjegjëse në DVP Tiranë, kishin bërë dezinfektimin e ambienteve të punës, si dhe të ambientit të shoqërimit dhe zyrës të shërbimeve për qytetarët të këtij komisariati, sipas një grafiku të miratuar në 5 faza për periudhën mars-qershor 2020.

Prej nisjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, ky komisariat është furnizuar disa herë dhe së fundmi me 100 copë maska mbrojtëse me një përdorim dhe disa përdorime, si dhe dezinfektantë për pastrimin e duarve, më datë 14.06.2020.

Nga këqyrja e ambienteve të komisariatit u konstatua se në ambientet e punës të stafit të këtij komisariati kishte mungesë të dezinfektantëve në vende të aksesueshme për pastrimin e duarve, si dhe nuk zbatoheshin rregullat për mbajtjen e maskës mbrojtëse nga punonjësit e policisë.

Ndërkohë, në disa ambiente të dukshme ishin afishuar postera për mbajtjen e maskave mbrojtëse nga punonjësit e policisë dhe qytetarët, si dhe kishte shenja orientuese për ruajtjen e distancës së rekomanduar prej rreth 2 metra.

Në këtë komisariat, nuk kishte termometër dixhital për matjen e temperaturës.

Furnizimi me ujë dhe energji elektrike ka qenë i pandërprerë gjatë kësaj periudhe. Furnizimi me ujë kryhej nga Ndërmarrja e Ujës-jellës Kanalizimeve Tiranë.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar në dhomat e shoqërimit. Gjatë inspektimit në dhomat e shoqërimit, u konstatua se ato nuk ishin plotësuar ende me karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar dhe me tavolinë pune. Ky shqetësim është konstatuar nga grupi i inspektimit të Mekanizmit Kombëtar në vizitën inspektuese të vitit të kaluar, për të cilin është rekomanduar kompletimi i menjëhershëm i dhomave të shoqërimit me pajisjet dhe orëditë e nevojshme. Mos kompletimi i tyre, tregon mungesë përgjegjësie dhe mosvlerësim të rekomandimeve të Mekanizmit Kombëtar nga drejtuesit dhe sektorët mbështetës në DVP Tiranë, por dhe nga drejtuesit e këtij komisariati.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për hartimin e një rregulloreje të unifikuar, për drejtorinë dhe komisariatet në varësi të saj, mbi masat mbrojtëse që duhet të zbatohen për periudhën në vijim, në ruajtjen dhe sigurinë e shëndetit të stafit të policisë dhe shtetasve që ju është privuar liria në mjediset e policisë, kundër infektimit me koronavirus (COVID-19).
2. Marrjen e masave të nevojshme, për planifikimin e fondeve në buxhetin e vitit që vjen, të dedikuara për blerjen e maskave, dorezave dhe dizifektantëve për stafet e policisë, si dhe për dizifektimin e ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në drejtorinë/komisariatet e policisë Tiranë, për shkak të kohëzgjatjes që do të ketë kjo pandemi.
3. Marrjen e masave nga sektori i logjistikës në DVP Tiranë, për shpërndarjen e mjeteve mbrojtëse shtesë si maska mbrojtëse, dezinfektantë dhe detergjentë, në komisariatet e policisë në varësi të saj, në bazë të numrit të punonjësve të policisë që kanë në organikë. Të furnizohet me mjete mbrojtëse shtesë Komisarati i Policisë nr.1, duke marrë në konsideratë faktin që, ky komisariat ka numrin më të madh të punonjësve në raport me komisariatet e tjerë dhe për rrjedhojë kompletimi paraqet domosdoshmëri.
4. Marrjen e masave për trajnimin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbime në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe atyre që ofrojnë shërbime ndaj qytetarëve, në ndërgjegjësimin e tyre për zbatimin e protokollit shëndetësor anti-COVID-19 në lidhje në mbajtjen e maskave dhe ruajtjen e distancimit fizik e social në kontaktet me njëri-tjetrin dhe me qytetarët, të cilët kërkojnë shërbime në mjediset e policisë.

5. Marrjen e masave, për shmangien për aq sa është e mundur të mbipopullimit të personave të ndaluar/arrestuar, përsa u konstatua në ambientet e sigurisë të DVP Tiranë dhe Komisarjatit të Policisë nr.3, pasi kjo gjë mund të ndikojë në përhapjen e sëmundjes infektive COVID-19 në mjediset e policisë.
6. Marrjen e masave shtesë në përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në drejtori dhe komisarjatet e policisë, kryerjen e dezinfektimit të vazhdueshëm të këyre ambienteve, duke vijuar me sigurimin e furnizimit të pandërprerë të ujit dhe energjisë elektrike përgjatë 24 orëve.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me termometër dixhital, postera informues dhe shenja distancimi të dukshme për të gjitha komisarjatet që kishin mungesa të tilla, si një kusht i domosdoshëm për parandalimin dhe përhapjen e COVID-19.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për kompletimin me karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar në të gjitha komisarjatet ku ka ambiente shoqërimit të shtetasve, kryesisht në mjediset e shoqërimit të Komisarjatit të Policisë nr.6, pasi kjo përbën shkelje të standardeve dhe trajtim jo dinjitoz të të shoqëruarve në mjediset e policisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA